



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, dhe nenit 65 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 77/16 gusht 2010), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-150 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/03 prill 2017), si dhe nenit 103, paragrafi 2, dhe nenit 114 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 11/11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2025, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR KONTROLLET E BRENDSHME DHE AUDITIMIN E BRENDSHËM TË INSTITUCIONEVE FINANCIARE JOBANKARE

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të plotësojë dhe ndryshojë Rregulloren për Kontrolltet e Brendshme dhe Auditimin e Brendshëm të Institucioneve Financiare Jobankare, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore më datë 27 dhjetor 2018 (më tutje: rregullorja bazë).

Neni 2

1. Paragrafi 15 i nenit 9 i rregullores bazë, ndryshohet si në vijim:

15. Udhëheqësi i funksionit të auditimit të brendshëm duhet:

- 15.1. Të plotësojë kriteret e përcaktuara në nenin 12 të Rregullores për Regjistrimin e Institucioneve Financiare Jobankare;
- 15.2. Të jetë i certifikuar në fushën e auditimit nga ndonjë:
 - 15.2.1. institucion i akredituar në Kosovë për këtë qëllim;
 - 15.2.2. institucion i mirënjohur ndërkombëtar; apo
 - 15.2.3. institucion relevant i akredituar për këtë qëllim nga organi kompetent në vendin në të cilin është themeluar për ofrimin e shërbimeve të certifikimit në fushën e auditimit.
- 15.3. Të jetë individ me reputacion të lartë etik e profesional dhe me kualifikim e përvojë adekuate në fushën e auditimit.

Neni 3
Dispozitat kalimtare

Institucionet financiare jobankare duhet të jenë në pajtueshmëri me kërkesat e kësaj Rregulloreje brenda afatit prej 2 (dy) vite nga data e hyrjes në fuqi e kësaj Rregulloreje.

Neni 4
Efektet dhe hyrja në fuqi

1. Të gjitha dispozitat tjera të rregullores bazë mbesin në fuqi, përveç dispozitave të ndryshuara dhe plotësuara me këtë Rregullore të cilat kanë efekt nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje.
2. Kjo Rregullore është pjesë përbërëse e rregullores bazë.
3. Kjo Rregullore hyn në fuqi më datë 1 mars 2025.

Dr.sc. Bashkim Nurboja
Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës